




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-19-6955-2-2-1/FA118
14 Nr. 1146/19
Dt. 01.11.2019

KONTRATË SHËRBIMI
(Kontratë Kornizë)

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. “ **Flamur Ramadani B.I.** “emri i biznesit **N.T.SH.** “ **Ramadani** “ me seli në Mitrovicë, me **ARBK: 810566234**, të cilët i përfaqëson **z. Flamur Ramadani**, në tekstin e mëtejme: **KRYESI I SHËRBIMEVE**,

janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve, si në vijim: :
Mirëmbajja dimërore e rrugëve lokale, me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	69	5	5	2	2	1
Prokurimi Nr.	644	1	9	1	0	9	2	2	1

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës është ekzekutimi i punimeve nga ana e Kontraktuesit, që ka të bëjë me: **mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale në territorin e Komunës së Vushtrrisë**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-19-109-221**.

- 1.1 Kjo kontratë është Kontratë Publike Kornizë dhe fillon së zbatuari nga data 01.11.2019 ndërsa përfundon 24 muaj pas nënshkrimit të kontratës respektivisht më dt. 30.10.2021 dhe e njëjta nuk mundë të zgjatet apo të vazhdohet.
- 1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim dhe / ose ekzekutim të shërbimeve me sasi të tyre përkatëse.
- 1.3 Sasi të shërbimeve dhe ose furnizimeve të saktësuara si në pjesën II. Lista e Çmimeve, (pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Shërbimeve) dhe të kësaj Kontrate nuk janë përcaktuar.
- 1.4 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bëjnë blerjen e shërbimeve të përmendura në pikën 1.1.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose punimeve do të filloi menjëherë pas dërgimit të ftesës nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit të shërbimeve dhe duhen të përfundohen në mënyrë cilësore dhe sasiore, sa më parë, me prioritet të lartë, duke angazhuar maksimalisht kapacitetin teknik adekuat si dhe personelin teknik në dispozicion të Kryesit të Shërbimeve.
- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Vlera e parashikuar e përafërt e Kontratës është në shumë prej: 102.211,96€
- 3.2 Çmimet njësisive të punimeve dhe / ose shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimeve e paraqitur nga Kontraktuesi, e cila është pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj Kontrate.
- 3.3 Kjo Kontratë Kornizë është me Çmime për njësi të shërbimeve dhe / ose punimeve.
- 3.4 Çmimet e saktësuara si në Përshkrimin e Artikujve pjesë e Dosjes së Tenderit dhe të kësaj Kontrate Kornizë duhet të jenë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës dhe Porosive të bëra. Ato janë të prera dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve.
- 3.5 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuar të cilat duhet të pasqyrojnë saktë sasinë - e punimeve dhe / ose shërbimeve të porositura nga Menaxheri i Kontratës - Komisioni i Pranimit të shërbimeve dhe / ose punimeve i Autoritetit Kontraktues.
- 3.6 Shumat do të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore të kushteve të kësaj Kontrate dhe Kushteve të Përgjithshme dhe / ose Kushteve të Veçanta të saktësuara në Dosjen e Tenderit.
- 3.7 Kontraktuesi ka për obligim që me rastin e fillimit të ekzekutimit të punimeve dhe / ose shërbimeve të respektoj detyrimet e tija në mënyrë që punimet dhe / ose shërbimet të jenë cilësore, në përshtatshmëri të plotë me kushte e kontratës, të përmbushin në tërësi Specifikat Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit si dhe të respektoj Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës. Kontraktuesi merr për obligim që ekzekutimi i punimeve dhe / ose shërbimeve të porositura të bëhet në mënyrë profesionale duke garantuar përdorim adekuat dhe cilësor të materialeve të porositura (rërës, kripës dhe pajisje tjera përcjellëse të saktësuara në Paramasë/Parallogari dhe / ose Specifika Teknike) në mënyrë që të garantojnë cilësi të shërbimeve dhe / ose punimeve të porositura për ekzekutim.

Neni 4 Ligji i aplikueshëm

4.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 5 Kualiteti

5.1 Kualiteti respektivisht cilësia e punimeve dhe / ose shërbimeve duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 6 Garancioni

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

6.1 Garancioni i cilësisë dhe përshtatshmërisë së ekzekutimit të shërbimeve dhe / ose punimeve është përgjegjësi ekskluzive e Kryesit të Shërbimeve.

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,10% në ditë të vlerës së shërbimeve dhe / ose punimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes të çfarëdo artikulli që përgatitet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 9 Nën-kontraktimi

9.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Kryesi i Punimeve dhe / ose Shërbimeve i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Kryesi i Punimeve dhe / ose Shërbimeve nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Kryesin e Punimeve dhe / ose Shërbimeve për vendimin e tij brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

10.1 Autoriteti kontraktues mundet që të ndërpres Kontratën menjëherë pasi të konstatoi se Kryesi i Punimeve dhe / ose Shërbimeve nuk po arrin ta përmbushë Kontratën në pajtim me përshkrimin Teknik të saktësuar në Specifikimin Teknik të Dosjes së Tenderit.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Kryesi i Shërbimeve

11.1 Kryesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Kryesit të Shërbimeve shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Kryesi i Shërbimeve nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 100 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Kryesit të Shërbimeve.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

12.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

12.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 13 Komunikimi

13.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Kryesit të Shërbimeve duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës se vendit
- (h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kryesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.




4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kryesin e Shërbimeve .

Për Kontraktuesin:

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Saranda Cakaj	Emri: për	Flamur Ramadani
Pozita:	Drejtoreshë për Prokurim Publik	Pozita:	Përfaqësues i Kryesit të Shërbimeve: N.T.SH. "Ramadani" – Mitrovicë
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.11.2019	Data:	01.11.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G Në kolonë F, duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%-8%-apo-48%; Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH , poashtu çmimin duhet ta shkrueni me dy decimale pas presjes dhjetore

Kategoria	Përshkrimi i shërbimeve/pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali ime TVSH-€
A	Makineria për hapjen e rrugëve dhe hedhjen e kripës dhe rërës								(Kategoria A 80% e pikëve në vlersim)
1	Furnizimi dhe transporti i kripës.	Ton	1.00	50.17	18.00	59.20	50.17	9.03	59.20
2	Furnizimi dhe transporti i rërës.	m3	1.00	6.78	18.00	8.00	6.78	1.22	8.00
3	Puna efektive e kamionit për hapjen e rrugëve dhe hedhjen e kripës dhe rërës 1	Orë	1.00	33.90	18.00	40.00	33.90	6.10	40.00
4	Puna efektive e kamionit për hapjen e rrugëve dhe hedhjen e kripës dhe rërës 2	Orë	1.00	25.42	18.00	30.00	25.42	4.58	30.00
5	Puna efektive e kamionit për hapjen e rrugëve dhe hedhjen e kripës dhe rërës 3	Orë	1.00	21.19	18.00	25.00	21.19	3.81	25.00
6	Puna efektive e ngarkuesit 1	Orë	1.00	33.90	18.00	40.00	33.90	6.10	40.00

Numri i prokurimit: VU644-19-6955-2-2-1apo nr. i brendshem: VU644-19-109-221Titulli: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale - E Korrigjuar

7	Puna efektive e ngarkuesit 2	Orë	1.00	25.42	18.00	30.00	25.42	4.58	30.00
8	Puna efektive e ngarkuesit 3	Orë	1.00	21.19	18.00	25.00	21.19	3.81	25.00
				TOTALI A:			217.97	39.23	257.20
B	Kujdestaria aktive dhe pasive si dhe angazhimi i makinerisë së veçantë								(Kategoria B 20% e pikëve në vlersim)
1	Puna efektive e eskavatorit me zinxhirë (vemza)	Orë	1.00	6.78	18.00	8.00	6.78	1.22	8.00
2	Transportues për transportimin e borës nga rrugët dhe trotuarët e qytetit 3	Orë	1.00	8.47	18.00	10.00	8.47	1.53	10.00
3	Mini eskavator për pastirimin e trotuareve	Orë	1.00	12.71	18.00	15.00	12.71	2.29	15.00
4	Kujdestaria aktive	Orë	1.00	4.07	18.00	4.80	4.07	0.73	4.80
5	Kujdestaria pasive	Orë	1.00	1.36	18.00	1.60	1.36	0.24	1.60
				TOTAL B:			33.39	6.01	39.40

REKAPITULLIMI



Kategoria	Përshkrimi	Gjimi total në €	Gjimi total me TVSH	Gjimi total i peshuar
A	Makineria për hapjen e rrugëve dhe hedhjen e kripës dhe rëres		257.2	205.76



Numri i prokurimit: VU644-19-6955-2-2-1apo nr. i brendshem: VU644-19-109-221 Titulli: Mirembajtja dimërore e rrugëve lokale - E Korrigjuar

B	Kujdestaria aktive dhe pasive si dhe angazhimi i makinerisë së veçantë	39.4	7.88
---	--	------	------

Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në baze të kesaj vlerë). Kjo është vlera e cila do të duhet të shënohet në Formularin e ofertes dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	N.T.SH. "RAMADANI"
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Flamur Ramadani
NËNSHKRIMI:	
DATA:	04.10.2019
VULA:	

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Qëllimi i projektit është mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane dhe atyre lokale në periudhën 15.11.2019 – 15.11.2021. Kjo nënkupton pastrimin e rrugëve urbane (qytetit) dhe rrugëve lokale nga shtresat e bores dhe akullit. Me këtë synohet të sigurohet qarkullimi i rregullt dhe i pa penguar i qytetarëve dhe mjeteve motorike nëpër rrugët lokale të Komunës së Vushtrrisë.

Mirëmbajtja e rrugëve të specifikuara duhet të filloi në momentin kur paraqiten ngrica në rrugë apo kur bora e shtresuar arrin trashësinë 5-10 cm.

- Periudha kohore e mirëmbajtjes është 15.11.2019 – 15.11.2021
- Numri i ditëve – 240
- Numri i orëve – 5760
- Gjatësia totale e rrugëve që duhet të mirëmbahen 294.26 [km]

Bazuar në të dhënat e statistikave meteorologjike në Kosovë, kemi këto shënime:

- Numri i ditëve me të reshura në viset rrafshinore 20 deri 22
- Numri i ditëve me të reshura në viset malore 22 deri 24
- Numri mesatar i ditëve me reshje i përvetësuar për planifikim – 22 për një sezone.

1 Sipërfaqet e rrugëve dhe trotuareve që duhet të pastrohen

N/R	Rruga	Gjatësia në m.	Sipërfaqja m ²
1	Skënderbeu	1250 x8	10 000
2	Dëshmorët e Kombit	1000 x5 900x14	5 000 12 600
3	Bulevardi „Adem Jashari”	380x10	3800
4	Bedri Pejani	300 x5	1 500
5	Ismajl Qemajli	620 x3	1 860
6	Wesly Clark	300 x3	900
7	Shemsi Istrefi	190x3	570
8	Mic Sokoli	280 x3	840
9	Tahir Sinani	300x5	1500
10	Nexhip e Ferat Draga	260 x3	780
11	Lidhja e Lezhes	370 x3	1 110
12	Enver Musa	450x4	1800
13	Faruk Beqiri	700 x3	2 100
14	Sheshi i Lirisë	60 x3	180
15	Krujës	400 x3	1 200
16	Tiranës	490 x3	1 470
17	Isak Halili	500x4	2000
18	Lumni Surdulli	1400x4	5600
19	Arsim Muzaqi	310x4	1240
20	Vllezërit Gërvalla	250x4	1000
21	Aziz Zhilivoda	125x4	500
22	Gjergj Fishta	300x4	1200
23	Xhevat Jusufi	185x4	740
24	Pandeli Sotiri	300x4	1200

Numri i prokurimit: VU644-19-6955-2-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-109-221 Titulli: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale

25	Bahri Kuqi	850 x3	2 550
26	Drenica deri te varrezat	1500 x3	4 500
27	2 Maji	700 x3	2 100
28	Hazir Gjaka	800x4	3200
29	Hamdi Gashi	1000x4	4000
30	Ajet Gërguri	550x4	220
31	Selatin Gërxhaliu	1450x4	5800
32	Jeton Terstena	3200x4	12800
	Gjithsejtë:	23 965 [m]	95 860 [m²]

*Janë llogaritur sipërfaqet e rrugëve së bashku me trotuare që kanë gjatësinë 95 860 [m²] apo 23.965 [km].

2. Rrugët lokale të Komunës.

N/R	Rruga	Gjatësia në [m]	Sipërfaqja në [m ²]
1	Smrekonicë – Pasomë	5 000	
2	M2-Banjskë	3 000	
3	M2-Sllatinë-Tërllabuq	8 000	
4	Dobërllukë	5 000	
5	Vushtri–Karaqë-Skromë-Boshlan-Vesekoc	20 700	
6	Vushtri (lagja e Rashicve) – Studime e Epërme	8 000	
7	Vushtri (zjarrëfiksat)-Sfaraqak	5 000	
8	M2-Sfaraqak	5 000	
9	M2-Nadakoc	3 000	
10	Samadrexhë – Sllakoc-Ropicë-Vilanc	9 000	
11	Maxhunaj-Dmnicë e Poshtme	2 000	
12	Dumnicë e Poshtme – Dumnicë e Epërme	10 000	
13	Magjistralë – Prelluzhë	5 000	
14	Magjistrale – Stanoc i Poshtëm	5 000	
15	Magjistrale-Stanoc i Epërm	5 000	
16	M2-Gracë	2 000	
17	Pestovë - Druar	3 000	
18	Pantinë – Oshlanë	10 000	
19	Akrashticë - Balinc	6 000	
20	Akrashticë - Liqej	5 000	
21	Shtitaricë	2 500	
22	Dalak (lagja Osmani)	2 500	
23	Stacioni hekurudhor - Bukosh	1 400	
24	Bukosh – Liqej-Taraxhë	7 000	
25	Bukosh – Nevolan - Bruznik (rruga e vjetër)	6 000	
26	Bruznik	3 000	
27	Duboc – Galicë Duboc te Antenat(Qyqavicë)	16 000	
28	Vërnice-Reznik-Shallc	8 000	
29	Vërnice – Kollë-Bruznik	5 000	

Numri i prokurimit: VU644-19-6955-2-2-1apo nr. i brendshem: VU644-19-109-221 **Titulli: Mirëmbajtja**
dimërore e rrugëve lokale

30	Reznik	4 000	
31	Druar (lagja Salihu)	3 300	
32	Druar (lagja e Nemozhve)	6 000	
33	Mihaliq – Beqok - Stroc	7 000	
34	Gllavotin - Beqok	5 500	
35	Bivolak – Stroc (tre lisat)	4 000	
36	Bivolak – Zhilivodë	4 000	
37	Bivolak - Hamidi	1 500	
38	Gumnishtë	8 000	
	Gjithsejtë.....	270 100 x 3	= 810 300 [m²]

TOTALI: 1+2, (23.96+270.30) ose (95 860+648 300) 294.26 [km].....744 160 m²

Mjetet e punës

Nr.	Mjetet e punës	Njësia	Sasia
1.	Kamion adekuat me mekanizëm për largimin e borës – plug dhe hedhës të kripës	Copë	3
2.	Ngarkues	Copë	3
3.	Eskavator me zinxhirë (vemza)	Copë	1
4.	Transportues për transportimin e borës nga rrugët dhe trotuaret e qytetit 3	Copë	2
5.	Mini eskavator për pastrimin e trotuareve	Copë	2

Vërejtje:

- Numri kamionëve është përcaktuar bazuar në të dhënat:
- Sipërfaqja totale e rrugëve **744 160 [m²]**
- Gjerësia e plugut -3m
- Gjatësia totale e rrugës që do ta kaloi kamioni. 294.26 [km]
- Koha e nevojshme e kamionit për ta kaluar këtë gjatësi është 14.713 orë (bazuar në lëvizjen kamionit 20 km/h).

Materiali i nevojshëm për mirëmbajtjen e rrugëve.

Bazuar se nevojiten 18g kripë/m² dhe 22 ditë me reshje bore kemi,

744 160m² x 0.018 kg/m² x 22 ditë = 294.687 kg. ose 295 x 2 = 590 t kripë.

Bazuar në raportin kripë – rërë (2:1), fitojmë sasinë e nevojshme të rërës prej 295 [m³]

Nr.	Materiali	Sasia për këtë periudhë
1.	Kripë	590 [ton]
2.	Rërë fraksion 2-5 mm.	295 [m ³]

Vërejtje: Varësisht nga reshjet e borës dhe intensiteti, sasia e kripës dhe rërës mund të ndryshoi.

Puna efektive e kamionit, ngarkuesit dhe kujdestaria

Bazuar se kemi 22 ditë me reshje bore, gjatë periudhës së mirëmbajtjes së rrugëve.

22 ditë x 24 h/ditë = 528 orë mirëmbajtje e planifikuar.

- Puna efektive e kamionit 1.....528 x 25%=132 x 2=264 h

Numri i prokurimit: VU644-19-6955-2-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-109-221 Titulli: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale

- Puna efektive e kamionit 2.....528 x 25%=132 x 2 =264 h
- Puna efektive e kamionit 2.....528 x 25%=132 x 2 = 264 h
- Puna efektive e ngarkuesit 1..... 528 x 10%= 53 x 2 =106 h
- Puna efektive e ngarkuesit 2..... 528 x 10%= 53 x 2 =106 h
- Puna efektive e ngarkuesit 2..... 528 x 10%= 53 x 2 =106 h
- Kujdestaria për 22 ditët me të reshura, bazuar në 12h / 24h kujdestari 528 x (12/24) =264 x 2 sezona =528 h
- kujdestaria për 98 ditët pa reshje, bazuar në 12h/24h kujdestari – 2352 h x (12/24) = 1176 x 2 sezona =2352 h.

(Kujdestaria bëhet prej orës 04:00 deri 08:00 prej 16:00 deri 20:00 dhe prej 22:00 deri 02:00, kurse në raste të jashtëzakonshme edhe në periudha të tjera kohore). Me kujdestari nënkuptohen mjetet e punës dhe punëtorët.

Numri i prokurimit: VU644-19-6955-2-2-1apo nr. i brendshem: VU644-19-109-221Titulli: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë : Ligji në fuqi në Republikën e Kosovës.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : gjuha e përdorur nga pala.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është : 10 % e çmimit të përgjithshëm të tenderit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Shërbimet brenda 2 (dy) ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është : konform afatit të përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit të kontratës, dhe shërbimet do të kryhen sipas porosisë nga njësia e kërkesë – Menaxheri i Kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha shërbimeve do të jetë : sipas afatit/kohë zgjatëjes , por jo më gjatë se 24 muaj në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0,10 % të çmimit përfundimtar të Kontratës, për ditë të vonuar. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Kontraktuesi – Kryesi i Shërbimeve dhe Menaxheri i Projektit i Autoritetit Kontraktues do të mbajnë dhe

Numri i prokurimit: VU644-19-6955-2-2-1apo nr. i brendshem: VU644-19-109-221Titulli: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale

		evidentojn shërbimet e përfunduara në Librin e shërbimeve, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, për të evidentuar gjitha përshkrimet e shërbimeve të ekzekutuara në terren, për të konfirmuar sasinë dhe cilësinë e materialeve të përdorura në objekt – vend punishte, gjithashtu për të evidentuar ecurinë e shërbimeve, pengesat eventuale, aktivitetet e ndërmarra për eliminimin e pengesave të shfaqura, kohëzgjatjen e kohës sa kanë zgjatur pengesat dhe në fund, pas përfundimit të shërbimeve, për të dhënë një Rekapitulim të ecurisë së punimeve përmes të dhënave në shifra dhe data.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit – Organi mbikëqyrës : do të emërohet me vendim të veçantë nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, pas nënshkrimit të kontratës. Do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e cilësisë, sasisë dhe përshtatshmërisë së punimeve në objekt, në pajtim me dispozitat e saktësuara si në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës dhe detyrat e përshkruara në vendimin mbi emërimin.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N / A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: N / A
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë : 2 (dy) ditë pas nënshkrimit të kontratës, por jo më gjatë se kohë zgjatja e përcaktuar në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuase e defekteve është :
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është : 10 % e çmimit të përgjithshëm të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Në pajtim me nenin 42 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.